VENDIM
Nr. 135, datë 10.8.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 71, DATË 22.4.2020, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "KALISI HYDROPOWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "VELESHICA 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 *kw* DHE "VELESHICA 2", ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 *kw*, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 13917 *kw*"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 10.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/3 prot., datë 4.8.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., mbi plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 3, të vendimit nr. 71, datë 22.4.2020, "Mbi licencimin e shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 71, datë 22.4.2020, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Kalisi Hydropower' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et 'Veleshica 1' me kapacitet të instaluar 5801 *kw* dhe 'Veleshica 2', me kapacitet të instaluar 8116 *kw*, me kapacitet total të instaluar 13917 *kw*", vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Veleshica 1", me kapacitet të instaluar 5801 kW, si dhe "Veleshica 2" me kapacitet të instaluar 8116 kw, me kapacitet total 13917 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të saj.

3. Shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k., të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19 vërtetimet e lëshuara nga prokuroria dhe gjykata e rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.

4. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 655, datë 22.4.2020, u njoftua shoqëria "Kalisi Hydropower" sh.p.k. në lidhje me vendimmarrjen e ERE-s për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, u njoftua shoqëria në lidhje me detyrimin për të depozituar në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i pandemisë COVID-19 (brenda datës 23.7.2020), vërtetimet e lëshuara nga gjykata dhe prokuroria e rrethit të Tiranës për shoqërinë dhe administratorin e saj.

- Më tej, me shkresën e ERE-s nr. 655/1 prot., datë 17.7.2020, është rikujtuar shoqëria në lidhje me plotësimin në afat të detyrimit të sipërcituar

- Në përgjigje, me shkresën e datës 22.7.2020, protokolluar në ERE, me nr. 655/2 prot., datë 22.7.2020, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nga të cilët nuk rezulton të ketë proces penal për shoqërinë dhe administratorin e saj, si dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilët nuk rezulton të ketë procedim penal në ngarkim të shoqërisë dhe të administratorit të saj.

- Sa më sipër, rezulton se shoqëria ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e munguar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 3, të vendimit nr. 71, datë 22.4.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020, "Mbi licencimin e shoqërisë "Kalisi Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Veleshica 1" me kapacitet të instaluar 5801 *kw* dhe "Veleshica 2", me kapacitet të instaluar 8116 kW*,* me kapacitet total të instaluar 13917 *kw*", shfuqizohet.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti